



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:063344

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06899262

KPPP.nr.2310/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Teba Dayanikli Tuketim Mallari” San. Ve Tic. Ltd, me adresë Organize San Bol. 8, Cad,Nr.16, Melik Gazi, Kayseri Turqi të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Durim Nevzati avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Thermo X” SH.P.K., me numër unik identifikues 810793332 dhe numër biznesi 70512947 me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Prizrenit nr.13 të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.391/22, i lejuar me datë 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 25.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Thermo X” SH.P.K., ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e P.nr.391/22, i lejuar me datë 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, për pjesën sa i përket detyrimit në lartësi prej 2,140.42€ për shkak të përmbushjes si dhe PËRFUNDOHET procedura përmbartimore për këtë pjesë të detyrimit.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Thermo X” SH.P.K., MBETET NË FUQI Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.391/22, i lejuar me datë 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, për pjesën e detyrimit të pa paguar sipas Faturës Nr.264531 të datës 15.10.2019, Faturës Nr. 264519 të datës 06.09.2019, Faturës Nr.10664 të datës 27.12.2018, Faturës Nr.10656 të datës 21.12.2018 në lartësi prej 12,859.58€.

- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.
- IV. URDHËROHET debitori “Thermo X” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 12,859.58€, në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
- V. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Teba Dayanikli Tuketim Mallari” San. Ve Tic. Ltd, ka lejuar procedurën e përmbarimit mbi bazën e dokumentit të besueshëm Faturës Nr.264531 të datës 15.10.2019, Faturës Nr. 264519 të datës 06.09.2019, Faturës Nr.10664 të datës 27.12.2018, Faturës Nr.10656 të datës 21.12.2018 dhe ka detyruar debitorin që në emër të faturave të papaguara, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 15,000.00€, me kamatë prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë, deri tek pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit.

Debitori, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se borxhi i paraqitur në prapësim nuk përputhet me borxhin real, pasi që sipas pasqyrave bankare të deponuara në gjykatë debitori thekson se ka kryer pagesën e borxhit në lartësi prej 81,324.02€, dhe se borxhi i mbetur është 12,859.58€ dhe jo shuma e pretenduar prej 15,000.00€. Tutje ka theksuar se debitori shpreh gatishmëri për pagesën e borxhit në lartësi prej 6,000€ sa i përket vlerës së radiatorëve ndërkaq kundërshton pjesën tjetër sa i përket vlerës së kaminave, bojlerave dhe nxemjes qendrore të cilat nuk i posedon debitori por personi i tretë me të cilin kreditori ka marrëveshje, e që pas shitjes së tyre mund të përmbushet obligimi ndaj kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj urdhrin përmbarimor. Po ashtu, ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e prapësimi sipas TOA në lartësi prej 208.00€.

Kreditori, përmes emailit nga Përmbaruesi Privat, ka pranuar prapësimin e debitorit me njoftimin për të drejtën e paraqitjes së përgjigjes në prapësim, mirëpo nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Pas shënimit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Komerciale e Kosovës, në lidhje me mungesën e përfaqësuesit për pranimin e shkresave dhe kthimit të lëndës tek përmbartuesi, gjykata me datë 18.10.2022 ka pranuar parashtresën përmes së cilës njoftohet së avokati Durim Nevzati është përfaqësues i kreditorit në këtë procedurë përmbartimore, i cili po ashtu ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Përgjigjen në prapësim të paraqitur pas kalimit të afatit ligjorë nga përfaqësuesi i kreditorit, gjykata nuk e vlerësoi fare.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me Urdhrin Përmbartimor P.nr.391/22, të datës 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit.

Gjykata erdhi në këtë përfundim pasi që përmes transferove bankare të realizuara përmes Pro Credit Bank, dhe atë transferit bankar nr.ref.550181859, 544798986, 532215488, 529217233, 505832169, 498187910, 496209465, 468611651 dhe 491387111 debitori nga borxhi total në lartësi prej 94,183.60€ sipas faturave Nr.264531 të datës 15.10.2019, Nr. 264519 të datës 06.09.2019, Nr.10664 të datës 27.12.2018, si dhe Nr.10656 e datës 21.12.2018, debitori e ka përmbushur detyrimin për pagesën e borxhit, përkatësisht shumën prej 81,324.02€, ku borxhi i mbetur rezulton të jetë 12,859.58€.

Andaj, gjykata nga borxhi i kërkuar nga kreditori në lartësi prej 15.000€, gjeti se debitori ka përmbushur borxhin në lartësi prej 2,140.42€ andaj në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit dhe atë në lartësinë prej 2,140.42€ andaj të njëjtin e anuloi.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin

e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesërishtme të kredisë në të holla të palës kreditore, sa i përket shumës prej 2,140.42€.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.391/22, i lejuar me datë 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, për pjesën tjetër të detyrimit, përkatësisht për shumën në vlerë prej 12,859.58€, për faktin se dokumentet e besueshme – faturat të cilat janë objekt i përmbartimit i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se të njëjtat nuk janë kontestuar nga debitori si dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara si dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 i LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e faturat ndonëse nuk janë dorëzuar në formë origjinale, të njëjtat nuk janë kundërshtuar nga debitori si dhe i njëjti ka bërë transfere të vazhdueshme të mjeteve për kryerjen e obligimeve sipas Faturës Nr.264531 e datës 15.10.2019, Faturës Nr. 264519 e datës 06.09.2019, Faturës Nr.10664 e datës 27.12.2018, Faturës Nr.10656 e datës 21.12.2018, andaj gjykata e la në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.391/22, të lejuar me datë 29.08.2022, nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale duke mos i njohur kreditorit shpenzimet për paraqitjen e përgjigjes në prapësim pasi që e njëjta është e pasafatshme.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për

pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 të LPP-së dhe në pikën III ka vendosur që nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese kjo në kuptim të 78 par. 4 të LPP-së.

Nga sa u tha më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2310/22, datë 25.02.2025

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.